REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 6084/1 Akti

Nr. .............. Vendimit

V E N D I M
I Gjyqtarit te vetem

Sot me dt. 11.09.97 me gjyqtar Altina Xhorxhaj

Pasi studiova kerkesen e ortakut te shoqerise TI-VA sh.p.k. Bashkia e Tiranes per depozitimin e vendimit nr.2188 dt 15.05.1997

K O N S T A T O J :

Se me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane nr.6084 dt 31.6.1994 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria TI VA sh.p.k.

Me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane nr.2188 dt 15.5.1997 eshte vendosur ne rruge gjyqesore caktimi i likujdatorit dhe emerimi i shoqerise ne likujdim e siper.

Kerkesa per depozitimin e vendimit te mesiperm te gjykates se rrethit Tirane, eshte e bazuar dhe e mbeshtetur ne nenin 24 dhe 30 te ligjit nr.7667 dt 28.1.1995.

Per keto arsye

Ne baze te nenit 24 dhe 30 te ligjit nr.7667 dt 28.1.1993

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses per depozitimin e vendimit nr.2188 dt 15.5.1997 te Gjykates se Rrethit Tirane per prishjen e shoqerise TI-VA sh.p.k..

Emerimi i likujdatores Flutura Stoja

Emerimi i shoqerise ne likujdim e siper

Publikimi e vendimit

Te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R J A
Altina Xhorxhaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

NR. 2032 Akti

NR. 2188 VENDIMI

# V E N D I M

## "NE EMËR TE POPULLIT"

REPUBLIKA E SHQIPERISE ARJANA MALLKOCI NOTERE TIRANE

Gjykata e Rrethit Tirane e përbere nga :

Gjyqtare - Altina Xhoxhaj

Nd. gjyqtare - Aida Lumi

" " - Mirvjena Cela

asistuar nga sekretare Majlinda Grabocka sot ne dt. 15.05.1997 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen civile me pale:

**PADITESE :** Bashkia e rrethit Tirane me cilesine e ortakut te shoqerise TIVA SH.P.K. përfaqesuar nga Natasha Kondi me autorisim.

**I PADITUR :** Shoqeria TIVA SH.P.K. përfaqesuar nga administratori i ortakut shqiptar Zemir Arenitasi dhe përfaqesuesi i ortakut Italian " Ital - Tubi " Llazar Thagi në mungese me dijeni.

**OBJEKTI :** Prishje e Shoqerise TIVA SH.P.K..

Baza ligjore neni 63, 72 i ligjit " Për Shoqerite Tregtare".

Gjykata pasi shqyrtoi ceshtjen :

## V E R E N

Paditesi i eshte drejtuar gjykates sipas objektit te padise.

Nga hetimi gjyqesor rezulton se me vendimin Nr. 6084 dt. 31.08.1994 te gjykates se rrethit Tirane eshte rregjistruar si person juridik shoqeria " TI-VA" sh.p.k. me ortak Bashkia e rrethit Tirane si përfaqesuese e ortakut shteteror Shqiptar me 51 % te kapitalit themelter dhe shoqeria " ITAL - Tubi" me përfaqesues Llazar Thagi me 49% te kapitalit themelter.

Kjo shoqeri ka pasur si objekt te saj prodhimin e materialeve te ndertimit , te elementeve betoni, ndertim rrugesh , uje sjellesh

... / ...

etj.

Ortaku shqiptar shteteror përfaqesuar nga Bashkia Tirane ka pasur ne shoqeri kontribute ne natyre te përbere nga mjetet e xhiros dhe makineri e pajisje. Por statuti i shoqerise nuk përmban vleresimin e kapitaleve konform nenit 42 te ligjit për shoqerite tregetare. Ortaket nuk kane emëruar nje ekspert kontabel për vleresimin e kapitaleve ne momentin e krijimit te shoqerise duke shkelur dispositat e ligjit "Për shoqerite tregetare ". Ata jane mjaftuar me depozitimin ne banke te shumes prej 100.000 lekesh.

Nga hetimi gjyqesor rezulton se gjate aktivitetit tre-vjeçar shoqeria rezulton me humbje te medha që kalojne gjysmen e kapitalit themeltar( shih librat e llogarise bashkelidhur dosjes). Ortaket nuk kane mundur te marrin vendim te vlef-shem mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise pasi ortaku italian nuk ka qene ne kontakt me ortakun shqiptar. Gji-thashtu edhe përfaqesuesi i ortakut italian Llazar Thagi megjithese u njoftua disa here nga gjykata nuk paraqitej ne se-anoe gjyqesore ndaj gjykimi u zhvillua ne mungese te tij.

Ne keto kushte ne pamundesi te nje vendimi te asamble-se se ortakeve te shoqerise, ortaku shteteror shqiptar konform nenit 72 paragrafi V i ligjit " Për shoqerite tregetare " i eshte drejtuar gjykates për prishjen e shoqerise TIVA sh.p.k. ne rruge gjyqesore.

Padia e paditesit eshte e mbeshtetur ne dispositat e ligjit " Për shoqerite tregetare " ndaj gmohet se duhet pra-nuar. Shoqeria"TIVA " emerohet si shoqeri ne likujdim e siper dhe likujdatore emerohet ekspertja Flutra Stoja.

Zyra e rregjistrit tregetar urdherohet te bej publiki-

... / ...

...min e ketij vendimi.

PËR KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 306 te K.Pr.C.

VENDOSI

+Pranimin e padise.

Prishjen e shoqerise " TIVA " sh.p.k.

Emertimin e shoqerise si shoqeri ne likujdim e siper.

Emerimi i likujdatores Flutra Stoja dhe publikimin e ketij vendimi ne regjistrin tregtar.

Shpenzimet gjyqesore siç jane bere.

Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes, për përfaqesuesin e pales Italiane Llazar Thaçi ky afat fillon nga marrja dijeni.

U shpall sot me 15. 05.1997

SEKRETARE / MAJLINDA GRABOCKA /

GJYQTARE / ALTINA XHOXHAJ/

Vertetoh et se ky vendim ka marre forme te prere me dt. 29.5.1997 ,ndersa per anen e paditur ne mungese me dt. 22.7.1997

Tirane me 22.7.1997

K/ SEKRETARE
FLUTURA KADIU

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 4500 Dt. 22.7.1997
VËRTETOHET FOTOKOPJA E
NJËJTË ME ORIGJINALIN

NOTERE
ARIANA MALLKUCI
Rr.KAVAJES.P,155
TIRANE - 425-74

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TE TIRANES
Nr 6084/2 i Aktit

Nr ________ Vendimit

# V E N D I M

## I Gjyqtarit te vetem

Sot me daten 9.01.98 me gjyqtar Altina Xhoxhaj , pasi studjova kerkesen e ortakut te shoqerise "Ti-va" sh.p.k, Bashkia e Tiranes, per zevendesimin e likujdatores Flutura Stoja:

## K O N S T A T O J :

se me Vendimin e Gjykates te Rrethit Tirane Nr. 2188 dt 15.5.1977 eshte vendosur me rruge gjyqesore caktimi i likujdatorit dhe emerimi i shoqerise ne likujdim e siper.

Me vendimin Nr. 6084/1 akti te gjyqtarit te vetem eshte vendosur:

a) pranimi i kerkeses per depozitimin e vendimit 2188 dt 15.5.1997 per prishjen e shoqerise Ti-va sh.p.k.
b) emerimi i likujdatores Flutura Stoja.
c) emerimi i shoqerise ne likujdim e siper.
d) publikimi i vendimit.

Likujdatorja Flutura Stoja nuk pranon te kryeje detyren e likujdatores per aresye objektive.

Sa me siper, bazuar ne nenet 281,282 te ligjit Nr 7638 dt.9.11.1992, cmohet te behet zevendesimi i likujdatores Flutura Stoja me likujdatorin Perparim Kadiu.

## P.K.A.

Gjykata ne baze te nenit 281,282 te ligjit 7638 date 19.11.1992

## V E N D O S I

Pranimin e kerkeses se Bashkise Tirane. Ndryshimin e likujdatores Flutura Stoja me likujdatorin Perparim Kadiu.
Te behet publikimi i Vendimit.
Urdherohet Zyra e Rgjistrimit te beje ndryshimet perkatese.
Kunder Vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

Tirane, me 9.01.1998

GJYQTARI
ALTINA XHOXHAJ